

VENDIM
Nr.75, datë 29.12.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Hilmi Dakli,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Bardha Selenica,	Anëtare e	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Hajredin Fuga,	Anëtar i	“““

me sekretare Drita Filto, më datat 12.11.1998 dhe 3.12.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.67 Akti që i përket:

KËRKUESE : HAJRIJE IBRAHIMI

KAFAZE PASHOLLARI, të përfaqësuar nga avokat Spiro Kasso, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: BEHIJE ÇETA, e përfaqësuar nga avokat Kostandin Trëndafili, me prokurë.

OBJEKTI:

Shpalljen antikushtetues të vendimit civil nr.683/1, datë 20. 7.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, në bazë të nenit 38 të Ligjit nr.7692, datë 31. 3.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

Kërkueset kanë parashtruar se vendimi nr.683/1, datë 20. 7.1998 është antikushtetues pasi kjo çështje është zgjidhur më parë me vendimin nr.683, datë 19. 5.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit dhe për rrjedhojë, në kundërshtim me rregullat e parashikuara nga nenet 481 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, i njëjti kolegji, për të njëjtën çështje ka marrë dy vendime të ndryshme, çka përbën një proces jo të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 38 të Ligjit nr.7692, datë 31. 3.1993.

GJYKATA KUSHTETUESE ,

pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesit të palës kërkuese, të përfaqësuesit të subjektit të interesuar dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Shkaqet e parashtruara nga kërkueset për shpalljen antikushtetues të vendimit nr.683/1, datë 20. 7.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, janë të drejta dhe për rrjedhojë kërkesa duhet pranuar.

Rezulton se mbi padinë e ngritur nga kërkueset, gjykata e rrethit Përmet me vendimin nr.943/1, datë 3.10.1996 ka vendosur pranimin e padisë së tyre, duke i njohur ato bashkëpronare në objektin e privatizuar nga subjekti i interesuar, Behije Çeta. Mbi ankimin e kësaj të fundit, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.192, datë 15. 1.1997 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit Përmet. Kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.683, datë 19. 5.1998 ka shqyrtuar në seancë rekursin e paraqitur nga Behije Çeta dhe pasi ka dëgjuar përfaqësuesit e palëve dhe prokurorin, ka vendosur mospranimin e rekursit. Pas dy muaj, kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, përsëri në seancë gjyqësore, ka marrë në shqyrtim për herë të dytë të njëjtën çështje dhe me vendimin nr.683/1, datë 10. 7.1998 ka vendosur prishjen e vendimit nr.192, datë 15.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë e të vendimit nr.943/1, datë 3.10.1996 të gjykatës së rrethit Përmet dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e rrethit Përmet. Pra, i njëjti trup gjykues, për të njëjtën çështje, njëherë ka vendosur mospranimin e rekursit dhe herën e dytë prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rigjykim. Sa sipër, rezulton e provuar jo vetëm nga ekzistenca e dy vendimeve,

njëri prej të cilëve u paraqit nga kërkuesit, por edhe nga shpjegimet që dha në seancë, para Gjykatës Kushtetuese, kryesekretari i Gjykatës së Kasacionit, i cili konfirmoi se të dy vendimet e kolegjit gjinden në kodeksin e vendimeve. Në këto rrethana, vendimi i dytë dhe pikërisht ai me nr.683/1, datë 20. 7.1998 është antikushtetues, për shkak se është shkelur një nga parimet esenciale të funksionimit të drejtësisë, i sanksionuar në dispozitat kushtetuese, sipas të cilit, vendimet e dhëna nga gjykata mund të anulohen, të prishen ose të ndryshohen vetëm me vendim të një gjykate më të lartë, në kushtet e parashikuara në ligj (neni 9 i Ligjit nr.7561, datë 29. 4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29. 4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”). Sipas Kodit të Procedurës Civile, kolegji i Gjykatës së Kasacionit, nuk ka të drejtë të anulojë, të prishë ose të ndryshojë vendimet e tij. Në këtë vështrim, shkeljet e lejuara në marrjen e vendimit të mësipërm e bëjnë procesin jo të rregullt ligjor dhe në aspektin e nenit 38 të Ligjit nr.7692, datë 31. 3.1993, deklarimin antikushtetues të këtij vendimi.

Gjykata Kushtetuese njëherazi konstatoi se edhe vendimi i parë i kolegjit civil nr.683, datë 19. 5.1998 është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor që gjithashtu në vështrim të nenit 38 të Ligjit nr.7692, datë 31. 3.1993, duhet të deklarohet antikushtetues. Ky vendim është marrë pa u shqyrtuar dosja (sepse ishte djegur gjatë trazirave të vitit të kaluar) dhe në këto kushte, kolegji civil nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka analizuar dhe rrëzuar pretendimet e palës që kishte paraqitur rekursin në të cilin parashtroheshin shkaqe ligjore për prishjen e vendimeve si zhvillimi i gjykimeve pa dijeninë dhe në mungesë të saj, apo pretendimi i gjësë së gjykuar. Në vendimin e kolegjit civil me shprehjen se : “rekursi i paraqitur nga e paditura përmban shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, për të goditur vendimin e gjykatës”, praktikisht nuk është arsyetuar rreth këtyre pretendimeve. Përderisa çështja është shqyrtuar në seancë gjyqësore, duke mos arsyetuar vendimin, kolegji civil ka shkelur rregullin kushtetues të përmendur në nenin 9 të Ligjit nr.7561, datë 19. 4.1992, sipas të cilit vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Në vijim të kësaj, edhe dispozitivi i vendimit të kolegjit civil nuk është në pajtim me kërkesat e ligjit procedural civil. Ky kolegji ka zbatuar rregullat e dhomës së këshillimit (neni 480 i Kodit të Procedurës Civile), kur duhej të zbatonte rregullat e seancës gjyqësore (neni 485 i Kodit të Procedurës Civile). Të gjitha këto shkelje të vlerësuara në tërësinë e tyre, e bëjnë edhe vendimin nr.683, datë 19. 5.1998 antikushtetues, rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor.

Dosja e dërguar nga gjykata e rrethit Përmet, përmban kopje vendimesh, shkresa dhe dokumente prej të cilave kuptohet se midis palëve janë zhvilluar disa gjykime për të njëjtën pronë, dosjet e të cilave mungojnë për të njëjtin shkak si dhe dosja e fundit. Në këto rrethana, në vështrim të paragrafit të nenit 37 të ligjit 8373, datë 15.7.1998, Gjykatës Kushtetuese ia dikton nevoja që për një zgjidhje me drejtësi të çështjes të shprehet për të dy vendimet e kolegjit, me qëllim që palët, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor të zgjidhin më pas mosmarrëveshjet që kanë për pronën objekt gjykimi, në vartësi të vendimit që do të marrë kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, pas shqyrtimit të rekursit të paraqitur në atë Gjykatë nga Behije Ceta.

PËR KËTO ARSYE ;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 34 e 41 të Ligjit nr.8373, datë 15. 7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, me shumicë votash.

VENDOSI:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.683/1, date 20.7.1998 dhe vendimit nr.683, datë 19. 5.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.